

VENDIM
Nr. 899, datë 18.11.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 921, DATË
29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PERSONELIN E
ADMINISTRATËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, pika 3, 8, pika 12, e 15, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pjesën VIII/1, të vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, shkronja “a”, pas nënndarjes “ii”, shtohet nënndarja “ii/1”, me këtë përmbajtje:

“ii/1. Koordinator i Rrjetit Antikorrupsion.”;

b) Në pikën 1, shkronja “b”, pas nënndarjes “ii”, shtohet nënndarja “ii/1”, me këtë përmbajtje:

“ii/1. Koordinator i Rrjetit Antikorrupsion luan një rol të posaçëm në luftën kundër korrupsionit, duke mbledhur, analizuar e koordinuar të gjithë informacionin për rastet korruptive të referuara nga burime të ndryshme. Koordinatori raporton pranë strukturës përgjegjëse për antikorrupsion, në ministrinë përgjegjëse për çështjet e antikorrupsionit, me qëllim parandalimin e goditjen e korrupsionit në administratën doganore, si dhe vlerësimin e rrezikut kundër korrupsionit dhe propozimin e rregullave për menaxhimin e këtij rreziku.”;

c) Në pikën 2, shkronja “d”, në fund të nënndarjes “i”, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion emërohet e lirohet nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave pas marrjes së propozimit nga ministri përgjegjës për çështjet e antikorrupsionit, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, për një afat 2- (dy-) vjeçar”.

Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion përgjigjet para ministrit përgjegjës për çështjet e antikorrupsionit për të gjithë veprimtarinë e ushtruar në rolin e koordinatorit, pjesë e rrjetit.

Koordinatori, në ushtrimin e detyrës e sipas nevojës, ka të drejtë të kërkojë mbështetje nga Drejtoria Antikorrupsion dhe e Standardeve Profesionale, si dhe nga strukturat e tjera doganore.

Detyrat, përgjegjësitë e koordinatorit, mënyra e funksionimit të rrjetit të koordinatorëve antikorrupsion, sistemi elektronik specifik, aksesit në të, përcaktohen me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për çështjet e antikorrupsionit.”.

2. Në aneksin nr.1 bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Te zyra e drejtorit të Përgjithshëm, poshtë rreshtit “Drejtor i Përgjithshëm”, shtohet rreshti si vijon:

Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion		1	
---------------------------------------	--	---	--

b) Totali i numrit për zyrën e drejtorit të Përgjithshëm të bëhet 8 (tetë);

c) Numri i pozicioneve “specialist”, në sektorin e Koordinimit për Mashtimet Fiskale, në Drejtorinë e Hetimit, të bëhet 7 (shtatë);

ç) Totali i numrit të punonjësve për Drejtorinë e Hetimit të bëhet 24 (njëzet e katër) dhe totali i punonjësve për Departamentin Operativo-Hetimor të bëhet 206 (dyqind e gjashtë).

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama